



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 30 prill 2012  
Nr. ref.: RK 228/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI 125/11**

Parashtruesi

**Shaban Gojnovci**

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës  
Supreme të Kosovës Rev. 217/2008, të datës 10.06.2011**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Cukalovic, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shaban Gojnovci nga fshati Lismir, Komuna e Fushë-Kosovës

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohet se janë bërë shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Kosovës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 217/2008, i datës 10.06.2011, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 01.08.2011.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 28 shtator 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 217/2008, të datës 10.06.2011, me anë të të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i është mohuar e drejta kushtetuese për punë.

## **Baza ligjore**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009, i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 28 shtator 2011, Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e z. Shaban Gojnovci dhe e regjistroi atë me nr. KI 125/11.
6. Më 3 tetor 2011, Kryetari i Gjykatës, me vendimin GJ.R. 125/11, e caktoi gjyqtaren Dr. Iliriana Islami si Gjyqtare raportuese, dhe të njëjtën ditë, me vendimin Ksh. Ki125/11, Kryetari i Gjykatës e caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje nga Robert Carolan (kryesues) dhe gjyqtarët Ivan Čukalović e Mr. sc. Kadri Kryeziu në cilësi të anëtarëve të Kolegjit.
7. Më 20 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës dhe parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

8. Më 28 shkurt 2001, Hekurudhat e Kosovës (në tekstin e mëtejme: HK) kishin nxjerrë Vendimin nr. 175 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për shkak të shkuarjes në pritje të pensionit, për punëtorin Shaban Gojnovci, të sistemuar në vendin e punës makinist, dhe atë nga data 28 shkurt 2001.
9. Në pikën dy të këtij vendimi përcaktohet se punëtorit i sigurohet beneficioni për shërbim afatgjatë në shumë prej 120 DM për tërë vitin.
10. Në hyrje të vendimit, si bazë juridike për nxjerrjen e tij përcaktohen: "Instruksionet Administrative 2001/3 të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës", të aprovuara më 27.02.2001". Ndërsa në arsyetimin e tij thuhet se në bazë të këtyre instruksioneve të gjithë të punësuarve aktiv e rezervë të HK-së (rreth 350 sish) e që në vitin 2001 kanë mbërri ose e mbërrinjë moshën 60 vjeçare ose kanë 35 vjet përvojë pune duke llogaritur edhe stazhin e beneficuar, do t'u akordohet ky beneficion material për shërbim afatgjatë.

11. Më 4 maj 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë ka nxjerrë Aktgjykimin CI. nr. 428/06 me të cilin ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e përfaqësuesit të paditësit, z. Gojnovci, dhe me këtë rast ka anuluar Vendimin e HK nr. 175, të datës 28.02.2001, duke detyruar të paditurën HK që paditësin ta kthejë në detyrat e punës së makinistit apo në ndonjë vend tjetër që i përgjigjet përgatitjes së tij profesionale duke ia njohur të gjitha të drejtat e marrëdhënies së punës nga data 28.02.2001.
12. Në arsyetimin e aktgjykimit të vet, Gjykata Komunale kishte theksuar se është konstatuar në mënyrë të pakontestueshme se paditësi kishte marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar tek e paditura dhe se "Instruksionet administrative" të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës, të 27 shkurtit 2001, nuk kishin fuqinë e akteve ligjore dhe se në kuptimin juridik –formal nuk ishin urdhëresa as rregullore të UNMIK-ut e as urdhëresa administrative, andaj shkëputja e marrëdhënies së punës duke u bazuar në dispozitat e tyre ishte e jashtëligjshme.
13. Kundër këtij aktgjykimi e paditura HK ka bërë ankesë në Gjykatën e kompetente të Qarkut në Prishtinë.
14. Më 26 shkurt 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin Ac. nr. 853/2007, me të cilin refuzoi si të pabazë ankesën e të paditurës HK dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë Ci 428/2006 e vërtetoi duke e lënë në fuqi.
15. Kundër këtij aktgjykimi e paditura HK, në afat ligjor, kishte paraqitur kërkesë për Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
16. Më 10 qershor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë Aktgjykimin Rev. nr. 217/2008, me të cilin ka aprovuar si të bazuar Revizionin e të Paditurës HK dhe me këtë rast ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 853/2007, të datës 26.02 2008, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë CI. nr. 428/06, të datës 04.05.2007, në mënyrë që kërkesëpadinë e paditësit, z. Shaban Gojnovci, për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës e ka refuzuar si të PABAZUAR.
17. Gjykata Supreme në arsyetimin e aktgjykimit të saj të revizionit kishte theksuar se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vërtetuar "drejtë dhe të plotë" gjendjen faktike lidhur me faktet vendimtare, por se në këtë gjendje të vërtetuar kanë aplikuar gabimisht të drejtën materiale sepse HK, në bazë të dokumentacionit faktik të prezantuar, kanë qenë të regjistruara dhe kanë operuar me emrin "Hekurudhat e UNMIK-ut" dhe kanë qenë të administruara nga UNMIK-u, në përputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47, të datës 18 gusht 2000: "UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuria e tij janë të liruara nga çfarëdo lloj procesi ligjor".
18. Më 28 shtator 2011, përfundimisht i pakënaqur me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Gojnovci ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me pretendim se atij i është shkelur e drejta e garantuar për punë sipas nenit 49 të Kushtetutës së Kosovës.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

19. Parashtruesi i kërkesës ka theksuar se me vendimin e kontestuar të autoritetit publik i është shkelur e drejta kushtetuese për punë (neni 49 - E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit).

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë.
21. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

Gjykata gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar".

22. Duke iu referuar shkeljes së supozuar të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të konventave e instrumenteve tjera ndërkombëtare nga ana e parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton:
23. Në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] pika 3 të Kushtetutës është qartazi e paraparë që: **"Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit."**
24. Në nenin **103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave]** të Kushtetutës, në pikën 2, është gjithashtu qartazi e përcaktuar se: "Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor."
25. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, dhe se roli i sajë (Gjykatës Kushtetuese) është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
26. Sa i përket shkeljes së pretenduar të së drejtës së garantuar për punë sipas nenit 49 të Kushtetutës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese thekson se Kushtetuta e Kosovës këtë të drejtë themelore të njeriut e garanton dhe i mundëson të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallim dhe në kushte të njëjta, ushtrimin e kësaj të drejte. Kushtetuta e Kosovës nuk i përcakton kushtet për gëzimin e kësaj të drejte, por këto kushte përcaktohen me ligje përkatëse të fushës së punës. Në këtë drejtim, nëse mënyra e themelimit, ndërprerjes apo kushteve tjera lidhur me punën janë respektuar, janë çështje të vlerësimit të ligjshmërisë dhe jo kushtetutshmërisë, andaj nëse ligji është aplikuar drejt apo jo është kompetencë e vlerësimit nga gjykatat e rregullta e që lidhen me çështjen e verifikimit të fakteve.
27. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese nuk gjen se parashtruesi i kërkesës të ketë ofruar ndonjë fakt qenësor se Gjykata Supreme, duke vendosur sipas kërkesës për revizion për të cilën shprehimisht është e autorizuar në bazë të nenit 212 të LPK-së, të ketë shkelur nenin 31.2 (E drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm), apo nenin 49 (E drejta e

garantuar për punë dhe zgjedhje të profesionit) për të cilët parashtruesi i kërkesës ka supozuar se janë shkelur.

28. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
29. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese nuk gjen fakte se Gjykata Supreme nuk ka gjykuar "drejt dhe paanshëm" duke sjellë vendimin si në revizionin e lartshënuar dhe nuk konstaton se me atë vendim të janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
30. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij", dhe Gjykata Kushtetuese nuk gjen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, andaj bazuar në rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe d, vendos që kërkesën ta refuzojë si qartas të pabazuar, dhe


### **PËR KËTO ARSYE**

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 18 janarit 2012, njëzëri:

### **VENDOSI**


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Dr. Iliriana Islami

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. Dr. Enver Hasani